



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA E LIPJANIT**  
**REPUBLIC OF KOSOVA**



**REPUBLIKA KOSOVA**  
**OPSTINA LIPJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

---

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	04.10.2022
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	Lënda: RAPORTI MUJOR I PUNËS – SHTATOR 2022

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2022, ju dorëzon:

**RAPORTIN MUJOR TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.09.2022-30.09.2022**

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM ka zhvilluar aktivitetet si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kerkesave të bartura. Gjatë muajit shtator janë pranuar gjithsejt 100 kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura kanë qenë gjithsejtë 138 lëndë, që në total rezultojnë të jenë 238 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 33 kërkesa, 26 të miratuara, 5 të refuzuara dhe 2 kërkesa janë bartur në sektorë të tjerë sipas kompetencës lëndore.

Statusi i trajtimit të lëndëve është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer apo ka marr pjesë edhe në:

- Zhvillimin e takimit për fillimin e punimeve për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal;
- Shqyrtimin dhe miratimin në Kuvendin e Komunës të Raportit për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës;
- Aktiviteti për shënimin e ditës “Lëvizja pa makina”;
- Janë nxjerrë aktet administrative të fazes së I-rë në bazë të Vendimit të Kuvendit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me dy pronarët privat.

Kishte edhe angazhime të veçanta në kuadër të komisioneve të ndryshme, legalizim, leje mjedisore komunale dhe në komisionin për emërtimin e rrugëve dhe hapësirave të tjera publike.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

- Intensifikimi i aktiviteteve për shqyrtimin e kërkesave;
- Angazhimet në procesin e hartimit të PZHK;
- Angazhimet në procesin e emërtimit të rrugëve dhe sistemit të adresave.

## STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Të pezulluara	Të refuzuar	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	12	11	5		3		15
2.	Leje ndërtimi/	6	15	6		1		14
3.	Leje renovimi, apo vendosje e objekteve të përkohshme							
3.	Leje rrënimi							
4.	Certifikatë përdorimi		1					1
5.	Informacione urbane	7		6				1
6.	LMK							
7.	Certifikate legalizimi /Leje Legalizimi	66	89	4		1		150
	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
8.	Kërkesa të tjera	9	22	5			2	24
9.	Gjithsejtë:	100	138	26		5	2	205

DISKUTIME PUBLIKE: Nuk kishte

### SFIDAT:

- Numri i lartë i kërkesave të bartura, përkatësisht rritja e tyre në dy muajt e fundit, sidomos për shkak të kërkesave të shumta për legalizim të objekteve. Në përfundim të afatit për parashtrimin e kërkesave për legalizim nga data 01.09.2022 deri me 05.09.2022 janë pranuar 66 kërkesa. Kjo datë shënon edhe përfundimin e afatit për parashtrimin e kërkesave
- Greva e filluar e punonjësve të administratës komunale nga data 25 gusht 22 kishte ndikim në efektivitetin e shqyrtimit të kërkesave. Ndikim të theksuar në shqyrtimin e kërkesave kishte edhe mungesa e dy punonjësve për shkak të pushimit mjekësor të tyre. Këto rrethana kanë ndikim të theksuar në mos trajtimin e të gjitha kërkesave brenda afateve ligjore.
- Edhe pas shqyrtimit të vazhdueshëm me anëtarët e Komisionit për trajtimin e kërkesave pa leje ndërtimi të kategorisë së II-të (legalizim) lidhur me përgjegjësitë e caktuara, Komisioni nuk është funksional. Duke pasur parasysh numrin e lartë të kërkesave, konsideroj se është e domosdoshme të angazhohen së paku dy punonjës me kontratë për shërbime të veçanta.